

Data: 07.03.2019

Ref.: 384/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Ligjin për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 62-të, të mbajtur më 12 shkurt 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të Fakultetit të Arteve si më poshtë:
 - Aktrim, BA, 240 ECTS;
 - Artet Aplikative, BA, 240 ECTS;
 - Artet Vizuele, BA, 240 ECTS;
 - Dizajn Skene dhe Kostumografi, BA, 240 ECTS;
 - Dramaturgji, BA, 240 ECTS;
 - Dramaturgji; MA, 60 ECTS, dhe
 - Regji Filmi dhe Televizioni, BA, 240 ECTS.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tash e tutje KShC) me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë, me datë 11.06.2018 ka njoftuar të gjitha IAL-të se nuk do të toleroi mos përmbushje të kriterëve të cilat derivojnë nga dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e arsimit të lartë, dhe se në secilin rast të konstatimit të mungesës së stafit akademik sipas dispozitave ligjore në fuqi, do të procedoi me tërheqje të akreditimit.

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësisë apo jo të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, KShC analizoj në detaje të gjithë dokumentacionin e stafit akademik të vendosur si bartës të programeve nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" të Fakultetit të Arteve. Pasi trajtoj të dhënat rreth numrit të stafit dhe fushat e studimit për secilin program të studimit, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sipas pika një (1) të nenit 21, të UA për Akreditim, "AKA e rezervon të drejtën të monitorojë dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Sipas pikës dy (2), "AKA mund të rishqyrtoj akreditimin e dhënë në çfardo kohe dhe/apo më pas të tërheq vendimin e sajë për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur".

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit".

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Ndërsa në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, thuhet: "IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor", pra IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, "Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit".

1. Për programin e studimit: Aktrim, BA, 240 ECTS, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Arbështa Grabovci-Nixha, Astrit Kabashi, Shkumbin Istrefi, dhe Ilire Vinca.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Arteve duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që Astrit Kabashi nuk është deklaruar fare brenda afatit të përcaktuar për deklarim të stafit akademik sipas nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim: "IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor", pra IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, "Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit".

Meqenëse i njëjti nuk është deklaruar brenda afatit ligjor, i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Aktrim, BA, 240 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Artet Aplikative, BA, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Lyra Zajmi-Binishi, Adem Rusinovci, Mehmet Behluli, dhe Nagip Berisha.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Fakulteti i Arteve për këtë program të studimit, u konstatua që Adem Rusinovci, dhe Mehmet Behluli janë deklaruar për angazhimin e tyre në këtë fakultet përmes sistemit E-akreditimi, por diploma e kualifikimit, kopja e letërnjoftimit dhe kontrata e punës nuk janë të qasshme. Te njëjtat dokumente u janë kërkuar institucionit që ti sjellin në kopje fizike, por asnjëherë deri me tani AKA nuk ka pranuar asnjë dëshmi të tillë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të dokumenteve të cekura me sipër, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Artet Aplikative, BA, 240 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Artet Vizuele, BA, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Valbona Rexhepi, Eshref Qahili, Ismet Jonuzi, dhe Valdete Vuçitërna.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Arteve duhet të ketë te paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që Valdete Vuçitërna nuk është deklaruar fare brenda afatit të përcaktuar për deklarim të stafit akademik sipas nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim: *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor"*, pra IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *"Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit"*.

Meqenëse i njëjti nuk është deklaruar brenda afatit ligjor, i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Përveç kësaj që u tha më lartë, Valbona Rexhepi e deklaruar për angazhimin e saj në këtë fakultet përmes sistemit E-akreditimi, por diploma e kualifikimit dhe kontrata e punës nuk janë të qasshme. Te njëjtat dokumente ju janë kërkuar institucionit që ti sjellin në kopje fizike, por asnjëherë deri me tani AKA nuk ka pranuar asnjë dëshmi të tillë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Artet Vizuale, BA, 240 ECTS*.

4. Për programin e studimit: *Dizajn Skene dhe Kostumografi, BA, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Sabri Shaqiri, Vlora Kosumi, Burim Gora, dhe Arian Krasniqi.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Arteve duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që Vlora Kosumi nuk është deklaruar fare brenda afatit të përcaktuar për deklarim të stafit akademik sipas nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim: *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor"*, pra IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *"Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit"*.

Meqenëse i njëjti nuk është deklaruar brenda afatit ligjor, i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Dizajn Skene dhe Kostumografi, BA, 240 ECTS*.

5. Për programin e studimit: *Dramaturgjia, BA, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Zymber Kelmendi, Haki Mulliqi, Besim Rexhaj, dhe Seadet Beqiri.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Arteve duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që Haki Mulliqi nuk është deklaruar fare brenda afatit të përcaktuar për deklarim të stafit akademik sipas nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim: *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo*

me larg se data 31 tetor”, pra IAL janë të obliguara që te deklarojnë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, “Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do te konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.

Meqenëse i njëjti nuk është deklaruar brenda afatit ligjor, i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore te sqaruara me lartë, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Dramaturgji, BA, 240 ECTS*.

6. Për programin e studimit: *Dramaturgji; MA, 60 ECTS*, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Haqif Mulliqi, dhe Emin Emini.

Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Arteve duhet te ketë te paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që Haqif Mulliqi, dhe Emin Emini nuk janë deklaruar fare brenda afatit të përcaktuar për deklarim të stafit akademik sipas nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim: *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor”,* pra IAL janë të obliguara që te deklarojnë stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do te konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.*

Meqenëse të njëjtit nuk janë deklaruar brenda afatit ligjor, të njëjtit nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore te sqaruara me lartë, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Dramaturgji, MA, 60 ECTS*.

7. Për programin e studimit: *Regji Filmi dhe Televizioni, BA, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi UP, Fakulteti i Arteve ka paraparë këta persona: Jeton Ahmetaj, Ekrem Xani, dhe Sylejman Klllokoqi.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit UP, Fakulteti i Arteve duhet te ketë te paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky fakultet për këtë program të studimit, u konstatua që për këtë program janë vendosur vetëm tre bartës, e jo 4 siç kërkohet sipas dispozitave ligjore të referuara më lartë, përkatësisht, Jeton Ahmetaj, Ekrem Xani, dhe Sylejman Kllokoqi. Përveç kësaj që u cek më lartë, Profesor Sulejman Kllokoqi i mungon diploma e kualifikimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Regji Filmi dhe Televizioni, BA, 240 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditës nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Arteve;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë